

REPublika e Kosovës
REPublika Kosova
Qendra për Shërbim të Qytetarëve
Centër za Uslugu Građana

Sh. 02 Nr. 39087
U. Br.

Nr. i faq. 2 Data: 29/12
Br. str. Datum:
KAMENICË/A



REPublika e Kosovës
REPublika Kosova / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



KRYETARI I KOMUNËS

Nr.389 datë: 29.12.2021

K a m e n i c ë

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 78 të Statutit Sh.01.nr.005/2008 të datës 26.09.2008 dhe Vendimit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit Sh.01.Nr.15/2010 të datës 31.05.2010 të Komunës së Kamenicës, nenit 53 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Propozimit nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për anulim të pjesërishtëm të Vendimit Nr.26937 të datës 30.08.2019. Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

1. MIRATOHET propozim vendimi Sh.02.Nr.37734 i datës 15.12.2021 i Drejtorisë Komunale të Arsimit Kamenicë, lidhur me shfuqizimin e pjesërishtëm të vendimit Sh.02.Nr.26937 i datës 30.08.2019 për riorganizimin e arsimit.
2. SHFUQIZOHET pika 1 paragrafi 1.2 dhe pika 2 paragrafi 2.2 i Vendimit Sh.02.Nr.26937 i datës 30.08.2019 për vijimin e mësimin në SHFMU "Fan S.Noli".
3. Nxënësit sipas nivelit 0 dhe 1 të ISCED (niveli parashkollor dhe arsimit fillor 1-5) dhe niveli 2 të ISCED (niveli i mesëm i ulët i shkollimit 6-9), vijojnë mësimin në SHFMU "Hasan Prishtina".
4. Mbetet në fuqi pjesa tjetër e Vendimit Sh.02.Nr.26937 i datës 30.08.2019 për vijimin e mësimin.
5. Obligohet Drejtoria Komunale e Arsimit që të njoftoj stafin arsimor dhe nxënësit për fillimin e mësimin në SHFMU "Hasan Prishtina".
6. Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Arsimit, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bënë Kryetari i Komunës.
7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është propozim vendimi Sh.02.Nr.37734 i datës 15.12.2021 i Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kamenicë dhe vendimi bazë Sh.02.Nr.26973 i datës 30.08.2019.

8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Me datë 30.08.2019, Komuna e Kamenicës ka marr vendim për riorganizimin e arsimit sipas nivelit 0 dhe 1 të ISCED-it (*Niveli parashkollor dhe arsimit fillor 1-5*) që sipas këtij vendimi në institucionin arsimor "Fan S. Noli" të vijonin mësimin nxënësit e SHFMU "Hasan Prishtina" si dhe riorganizimin e nivelit 2 të ISCED-it (Niveli i mesëm i ulët i shkollimit, 6-9) që në institucionin arsimor "Fan S.Noli" të vijonin mësimin edhe nxënësit e SHFMU "Hasan Prishtina".

Bazuar në propozimin vendimin Sh.02.Nr.37734 të datës 15.12.2021 të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kamenicë, se në këto shkolla të Komunës së Kamenicës sipas gjendjes faktike në terren nuk është duke u zhvilluar mësimi, si pasojë nga mospajtimet rreth riorganizimit të vijimit të mësimit dhe transferimin e nxënësve në shkolla të tjera, kjo bëri të pamundur që në intitucionet arsimore të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, të mbahet mësimi nga data e marrjes së vendimit për riorganizim përkatësisht me datë 30.08.2019 e deri më sot.

Nga fakti se vendimi i tillë nuk ishte marrë në pajtim me nenin 20 paragrafi 20.1 të Statutit të Komunës së Kamenicës, që thotë se Komuna duhet të konsultoj publikun në mënyrë që të siguroj se vendimi i marrë është bazuar në fakte apo që të jenë marrë parasysh sugjerimet dhe përvojat e qytetarëve që të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë, kjo bëri që të pasojë humbja e mësimit në vazhdimësi nga qindra nxënës, nga marrja e vendimit e deri më sot.

Pra, bazuar në Propozimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Kamenicë, se në shkollat e lartëcekura nuk është duke u zhvilluar mësimi, Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 53 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që ky vendim të shfuqizohet pjesërisht për institucionet arsimore në të cilat nuk është duke u zhvilluar procesi mësimor dhe vijimi i rregullt i mësimit.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit
- DKA-së
- MASHT-it
- QSHQ-arkiv

Kryetari i Komunës

Kadri RAHIMAJ

